



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE

REKTORATI

DREJTORIA E MENAXHIMIT TE BURIMEVE NJERËZORE SJI P-A

Nr.690 prot.

Tiranë, më 20/07/2023

Agjencisë së Prokurimit Publik

Buletini i Njoftimeve Publike

Tiranë

Lënda: Botim Njoftimi.

Rektorati i Universitetit të Arteve, shpall konkursin për (një) vend të lirë pune për punonjës administrate si më poshtë:

I. Drejtoria Ekonomike & Investimeve Prok.Blerje

- Përgjegjës Sektori (shpenzimeve dhe vlerave materiale) - 1

1. Kandidati për pozicionin e lirë të punës së **Përgjegjës Sektori**, duhet të plotësojë këto kritere:

- 1.1 Të ketë kryer arsimin e lartë në fushën Ekonomike (master i shkencave/ekuivalente me të sipas LAL, mesatarja e përgjithshme e notave mbi 7.5). Në rastet kur studimet janë kryer në një shkollë të lartë jashtë vendit, diploma duhet të jetë e njehsuar nga MAS&R.;
- 1.2. Të ketë minimumi 4 vjet eksperiencë pune në fushën (për të cilin është hapur ky pozicion pune);
- 1.3. Të ketë aftësi të plota për të vepruar;
- 1.4. Të ketë vlerësime pozitive pune nga punëdhënësi i fundit;
- 1.5. Të jetë në kushte të shëndetshme që e lejojnë të kryejë detyrën;
- 1.6. Të ketë aftësi të mira komunikuese, menaxhuese, raportuese dhe të dijë të komunikojë në grup, në zbatim të Kodit të Etikës;
- 1.7. Të ketë dëshmi të një nga gjuhët ndërkombëtare (preferohet anglisht);
- 1.8. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prere nga Gjykata, për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtje penale me dashje;



Dokumentacioni që duhet të plotësojë çdo dosje e kandidatit, duhet të përmbajë materialet e mëposhtme:

- Kërkesë nga kandidati ku të jetë përcaktuar specialiteti për të cilin konkurron;
- Diplomë origjinale + listë notash/ fotokopje e noterizuar që vërteton kryerjen e arsimit të lartë (për kandidatët që kanë mbaruar jashtë shtetit, njehsimi nga MASR);
- Jetëshkrimi (CV), i shoqëruar me dokumentacionin përkatës që vërteton elementët e paraqitur në të;
- Dokument (fotokopje e librezës së punës), që vërteton përvojën në punë;
- Letër reference/vlerësim pune nga punëdhënësi i fundit;
- Dëshmi e gjuhës së huaj;
- Kopje e letër njoftimit ose kartës së identitetit;
- Çertifikatë familjare/personale;
- Dëshmi e gjendjes gjyqësore;
- Dëshmi e gjendjes mjekësore;

Konkurrimi do të bazohet në plotësimin e kriterëve profesionale të rektoratit dhe njohjen e ligjshmërisë në fuqi, kryesisht në Ligjin nr.80/2015 për “Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL, në Republikën e Shqipërisë”, “Për Buxhetin”; “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”; “Kodi procedurave Administrative”; Kodin e Punës në RSH” ; ”, Statutin e Universitetit të Arteve.

Dosjet e kandidatëve do të dorëzohen në Drejtorinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në UART, duke filluar nga data 24/07/2023 deri më datë 07/08/2023 ora 14.00.

Për datën e konkursit kandidatët të informohen pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, në Rektoratin e Universitetit të Arteve, çdo ditë nga ora 08.00 deri në orën 14.00.


Msc. Alma SINANAJ
ADMINISTRATOR
UNIVERSITETI I ARTEVE